



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 09.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, LIDHUR ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 09.07.2018 shqyrtoi projektligjin *Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës* “në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Kuvendi ka ratifikua me ligjin nr.116/2013, marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP”).

Marrëveshja e sjellë për ratifikim, është në përputhje me nenin 10, të ligjit nr.43/2016, ku pas negociimit dhe konkludimit të projektit të dakordësuar mes palëve, marrëveshja iu nënshtroa procesit të miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave, dhe po shqyrtohet për tu ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Qëllimi i këtij projektligji është që të përfshijë në marrëveshjen me qeverinë pritëse dispozita që rregullojnë trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit TAP, kryesisht për të përfshirë zbatimin e skemës së autofaturimit në lidhje me TVSH-në e investitorit të projektit dhe kontraktorëve për sa i përket furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Nisur nga kërkesat e paraqitura tashmë nga projekti TAP, por dhe fluksin në rritje të tyre që pritet të vijojë në vitet 2018 e 2019, mendohet se është i nevojshëm rishikimi i skemës së TVSH-së dhe kalimi në skemën e kombinimit të sistemit të autofaturimit (*reverse-charge*) me sistemin tradicional të aplikimit të TVSH-së.

Përdorimi i skemës së re do të sjellë rimbursimin e përshpejtuar të TVSH-së.

Kjo skemë nënkupton se gjatë fazës së ndërtimit (sikurse përcaktohet në marrëveshjen me qeverinë pritëse), të gjitha furnizimet e nevojshme ndërkombëtare/të huaja dhe vendase të lidhura me projektin TAP, në nivelin e parë dhe të dytë të furnizimeve për projektin TAP do t'i nënshtrohen TVSH-së, nëpërmjet sistemit të autofaturimit

Mekanizmi i *reverse-charge* parashikohet nga direktiva e BE-së nr.2006/112/EC “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, në nenet 194 deri 199 të saj si përjashtim ndaj rregullit kryesor që TVSH-ja është e pagueshme nga personi që kryen furnizimin. Gjithashtu, mekanizmi i *reverse-charge* është një mekanizëm që është përdorur në Shqipëri në kuadër të legjislacionit fiskal, pra, tashmë është i njohur për autoritetet shqiptare

5.0 Diskutimet në Komision :

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit dhe në përgjigjet e dhëna nga drejtuesit e institucioneve, pyetjeve të tyre u sqaruar rreth arsyeve të ndryshimit të marrëveshjes, si dhe lehtësirat që krijohen me këtë ndryshim të propozuar.

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për ratifikim në zbatim të nenit 81, pika 1 dhe 121 pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjes “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës “është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’”

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kreu II”Marrëveshjet Ndërkombëtare, në neni 121 i saj. Marrëveshja është hartuar, mbështetur në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligji për ratifikim;

b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;

c) vendimi i miratimit në parim;

ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;

d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;

dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Nga shqyrtimi i marrëveshjes kjo procedurës është zbatuar.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

